



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

---

Numri i lëndës: 2019:237798

Datë: 14.11.2019

Numri i dokumentit: 00649520

**P.nr.483/2019**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA SKENDERAJ**-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mentor Hajraj dhe me procesmbajtësen Aferdita Isufi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit A. (H) M nga fsh. ..., komuna e ..., për shkak të veprës penale –Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Dep. i Përgjithshëm PP.II.nr.2392/19,të dt.01.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.12.11.2019, i cili ishte publik e verbal, në të cilin prezent ishin prokurorja e shtetit Jakodinka Nikoliq, i akuzuari A.M, mbrojtësi i të akuzuarit av.R.D dhe përkthyesi i gjykatës Sh.H, të njëjtën ditë e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa me dt. 14.11.2019, e përpiloj këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **A.M**, i biri i H. dhe Xh., e vajzërisë K., i lindur me dt...., në ..., tani me vendbanim në fsh...., komuna ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal: ....

### **-Ë S H T Ë F A J T O R Ë -**

**SEPSE:** me datë 26.03.2019 rreth orës 15:25 në Skenderaj, në Rr."....", hyrja e ...-rë, kati i ...-të, nr...., pa autorizim posedoi substanca narkotike për nevoja personale, në atë mënyrë që gjatë kontrollit në adresën ku ai jeton është gjetur një qese me substancën e dyshuar narkotike me peshë 21,82 gr. dhe qesja tjetër me substancën e dyshuar narkotike me peshë 21,68 gr. të dy qese me substancë narkotike, e cila përmban substancën bimore, ngjyrë gjelbërt- kanabis (mariuhana) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), me peshë totale 39,37, e cila me këtë rast iu konfiskua.

**Me këtë ka kryer veprën penale-** Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të se njëjtës dispozite ligjore si dhe nenit 41, 46, 49, 50, 51 52, dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 365, 450, 453, dhe 463 të KPP-së, të akuzuarin e :

## GJYKON

Të akuzuarit gjykata i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vjet, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej dy (2) vjet nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale, **dhe** dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind euro) të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e përcaktuar nga gjykata atëherë ky dënim do të zëvendësohet sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësor obligohet të paguaj shumën prej 10 euro, dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit obligohet të paguaj shumën prej 30 euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati.

Gjykata në bazë të dispozitës ligjore nga neni 69 par.1 të KPRK-së, lidhur neni 275 par. 3 të KPRK-së, **konfiskon** substancën narkotike të llojit marihuanë në peshë neto prej 39.37 gram.

Autorizohet Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëjë asgjësimin e kësaj substance narkotike.

## Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën e saj, PP.II.nr.2392/2019, të dt.01.10.2019, e ka akuzuar A. (H) M nga fsh. ..., komuna ..., për shkak të veprës penale - Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 12.11.2019, gjykata të akuzuarin hollësisht e njoftojë me të drejtat e tij procedurale në cilësinë e palës së akuzuar. I njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës e ka angazhuar me autorizim- av. R.D.

Në shqyrtimin fillestar në gjykatë aktakuzën e përfaqësoi prokurorja e shtetit Jakodinka Nikoliq, e cila pas leximit të aktakuzës bëri përmirësimin e mbiemrit të të akuzuarit që duhet të jetë M. dhe bëri ricilësimin e veprës penale, sipas ligjit i cili ka qënë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale "Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së".

Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, gjykata të akuzuarin hollësisht e ka njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë.

I akuzuari në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, pas

konsultimit të mjaftueshëm më mbrojtësin e tij, shprehu keqardhje për rastin që i ka ndodhur i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do t'i përsëris veprimet e tilla.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri gjykata e kërkoi mendimin nga prokurorja e shtetit dhe nga mbrojtësi i të akuzuarit.

Prokurorja e shtetit me këtë rast deklaroi se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në mënyrë vullnetare pa imponime, ky pranim fajësie ka mbështetje në shkresat e lëndes, andaj i propozoi gjykatës që të aprovojë këtë pranim fajësie.

Mbrojtësi i të akuzuarit – av. R.D lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi së pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ngase i njëjti është i vetëdijshëm dhe i ka kaptuar pasojat e pranimit të fajësisë. Deklaroi së të gjitha shkresat e lëndës janë të pranueshme dhe i propozoi gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh këtë fakt si rrethanë lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari dhe pas marrjes së mendimit nga prokurorja e shtetit dhe nga mbrojtësi i të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore të nenit 248 par.4 të KPP-së, ka marr vendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze nga se konsideroj se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ndaj këtij të pandehurit duke i shqiptuar dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para së gjithash në bazë të pranimit të fajësisë nga i akuzuari pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndes siç ishin: vërtetimi mbi sendet e konfiskuara, me datë 26.03.2019, gjetjen dhe mendimin e ekspertit të forenzikës pranë Agjencionit të Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, me datë 10.07.2019, procesverbali mbi bastisjen e banesës, me datë 26.03.2019, raporti nga evidenca penale në emër të të pandehurit si dhe nga vështrimi në fotodokumentacion dhe shkresat tjera të lëndës.

Duke u mbështetur në këto fakte dhe prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale- Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, ngase i njëjti me datë 26.03.2019 rreth orës 15:25 në Skenderaj, në Rr."...", hyrja e ...-rë, kati i ...-të, nr...., pa autorizim posedoi substanca narkotike për nevoja personale, në atë mënyrë që gjatë kontrollit në adresën ku ai jeton është gjetur një qese me substancën e dyshuar narkotike me peshë 21,82 gr. dhe qesja tjetër me substancën e dyshuar narkotike me peshë 21,68 gr. të dy qese me substancë narkotike, e cila përmban substancën bimore, ngjyrë gjelbërt- kanabis (mariuhana) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), me peshë totale 39,37, e cila me këtë rast iu konfiskua, për çka gjykata të akuzuarin e shpalli penalisht përgjegjës dhe i'a shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata e pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit si dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe

rënduese të parapara në nenin 73 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin së i njëjti gjate shqyrtimit fillestar e pranoje fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmoj në mase të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, rrethanat e tij personale, nga se i njëjti është i moshës së re, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethanë rënduese e gjeti faktin së veprën penale e ka kryer me dashje.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi-dënim të kushtëzuar dhe dënim me gjobë, ngase gjykata vlerësoi së tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndaloj që kryerësi të mos kryej vepër penale dhe me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të dispozitës ligjore nga neni 69 par.1 lidhur me nenin 275 par.3 të KPRK-së, vendosi që t'ia merr-konfiskojë të akuzuarit substancën narkotike të llojit marihuanë në peshë neto prej 39,37 gram, njëheritë autorizoi Policinë e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëjë asgjësimin e kësaj substance narkotike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2. 6 lidhur me nenin 453 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Meqenëse nuk kishte palë të dëmtuar në këtë çështje penalo-juridike për të udhëzuar të njëjtin në kontest të rregulltë civil, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga si u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,DEGA SKENDERAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr. 483/19, dt.14.11.2019**

Procesmbajtësja  
**Aferdita Isufi**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Mentor Hajraj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.